




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 31.3.2016, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së dhe Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së.

Munguan: Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit dhe Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Qëndron Kastrati** propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika e shtatë - **Shqyrtimi i kërkesës për sigurimin e hapësirës për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme për ndërtimin e Qendrës për takimet e lutjeve të mëngjesit**, pasi që nuk ka ardhur materiali i mjaftueshëm për këtë mbledhje, sepse pritet një kërkesë prej Qeverisë së Kosovës për t'iu shmangur konkurrencës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozimvendimi për plotësim, ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale;**
- 3. Propozimvendimi për lënie në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave;**
- 4. Raporti përfundimtar buxhetor për vitin 2015;**

5. Propozimvendimi për dhënien e pronës komunale KEDS-it;
6. Propozimvendimi për vazhdimin e afatit shtesë për lirimimin e hapësirave nga AKP;
7. Të ndryshme.

Njësëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëësëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për plotësim, ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Kryesuesi konstatoi se njëësëri u përkrah Propozimvendimi për plotësim, ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për lënie në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Sami Hamiti përkrahu dërgimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në diskutim publik.

Dardan Sejdiu u shpreh se ligji na obligon për një rregullore për menaxhimin e mbeturinave, dhe tani ne e kemi një rregullore të tillë, e cila është në përputhje me ligjin. Kjo Rregullore është hartuar në bashkëpunim me GIZ-in. Dokumentin të cilin e kemi propozuar për diskutim publik, është dokument që në vete përfshinë disa elemente, por që në fakt krijon një model të operimit për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Prishtinës. Ka disa elemente që ndryshojnë prej modelit ekzistues, këto janë kërkesa ligjore. Ai ceku se te shtojca A – Tarifat / taksat e shërbimit nuk ndryshojnë, mbesin tarifat / taksat e shërbimit që ekzistojnë tani.

Sa i përket raportit përfundimtar për buxhetin e vitit 2015 dhe rregullores së re për temat që ndërliidhen me këtë rregullore, janë të parapara në buxhetin e vitit 2016 dhe kanë të bëjnë me rregullimin e hapësirave, ku mblidhen mbeturinat qoftë edhe ato të kontejnerëve nëntokësorë etj.

Agim Salihu tha se në vendim jepet data 9.5.2016, se deri kur do të bëhen konsultat paraprake për Rregulloren, mirëpo këtë datë duhet ndryshuar.

Laura Zherka pyeti se sa i ka plotësuar Komuna kushtet për zbatimin e kësaj rregulloreje. Ajo si shembull ceku deponinë për materiale të ngurta dhe pyeti se çka ka bërë komuna lidhur me këtë.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me këtë, duke thënë se Kuvendi i Komunës së Prishtinës në vitin 2014, ka ndarë një lokacion për ndërtimin e deponisë së mbeturinave të ngurta. Lokacioni ka qenë në diskutim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Materialin e kërkuar e kemi dërguar në Ministri, së bashku me Vendimin e Kuvendit të Komunës. Ministria e ka verifikuar lokacionin dhe kanë ardhur në përfundim se vendi për lokacionin për ndërtimin e deponisë nuk është adekuate për shkak të afërsisë me liqenin.

Kemi filluar prapë diskutimet me Ministrinë rreth përcaktimit të këtyre kufizimeve që janë rreth liqenit, kemi zotimin se gjatë muajit prill do ta dhënë konfirmim për kërkesën tonë.

Qëndron Kastrati u shpreh në mbështetje të Propozimvendimit për lënie në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave. Drejtoria përkatëse dhe ekspertët që po merren me hartimin e kësaj rregullore, sugjerimet që do t'i bëjmë në Kuvend, duhet t'i marrin parasysh në hartimin përfundimtar të rregullores.

Kryesuesi e përkrahu dërgimin e rregullores në Kuvend, e cila hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, dhe kërkoi që te dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, të përmirësohet data, të mos jetë 1 prilli.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Raporti përfundimtar buxhetor për vitin 2015.

Dardan Sejdiu, lidhur me këtë raport tha se ky është obligim ligjor, andaj është dërguar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe do të dërgohet edhe në Kuvendin e Komunës, ku do të trajtohet hollësisht. Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës do të jetë më adekuat në aspektin e diskutimeve.

Sami Hamiti u shpreh se raporti ka mangësi edhe në aspektin e të dhënave dhe shënimeve që një raport përfundimtar do të duhet t'i kishte, jo vetëm projektet e lidhura drejtpërdrejt me zonat buxhetore, por të gjitha projektet që kanë qenë të evidentuara në fillim të vitit, kur është aprovuar buxheti dhe bartja e buxhetit, pra mungon një evidencë.

Kemi mospërputhje në mes aprovimit të buxhetit dhe asaj që kemi në tabelë. Te tabela e të hyrave vetjake në aprovim të buxhetit të vitit 2014 dhe 2015, i kemi edhe participimet dhe donacionet që janë përfshi dhe dy vendet i kemi të ulëta planifikimin e të hyrave vetanake dhe për vitin 2014 dhe 2015 për 500.000 €.

Ai përkrahu dërgimin e raportit për Kuvend, mirëpo kërkoi që për mbledhje të Kuvendit dokumenti të ketë sqarime shtesë, sepse mungon lista e projekteve që kanë qenë të planifikuara dhe projekteve që kanë mbetur pa u realizuar.

Dardan Sejdiu tha se Drejtoria e Financave do t'i marrë parasysh sugjerimet për pasurimin e raportit me informacionet që i kërkuat.

Laura Zherka kërkoi nga drejtori i Drejtorisë së Financave që për seancën e Kuvendit, fondi i shkronjave të mos jetë 6, sepse shumë vështirë po lexohen.

Dardan Sejdiu tha se materialin do ta shtypin në formatin A 3.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrash Raporti përfundimtar buxhetor për vitin 2015, me kërkesën që të pasurohet me sqarime shtesë që u kërkuan për Kuvend, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës komunale KEDS-it.

Dardan Sejdiu theksoi se fjala është për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim KEDS-it.

Sami Hamiti bëri vërejtje në material, te propozimi, në pasusin e fundit të arsyetimit, ku thuhet se Kryetari i propozoi Kuvendit të Komunës dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës KEDS-it, në afat të pacaktuar, ndërsa në Vendim e kemi: Jepet në shfrytëzim për periudhën afatshkurtër - 15 vjet, d.m.th. këtu kemi dallimin. Ai tha se vendimi duhet të përmirësohet dhe arsyetimi të jepet më mirë. KEDS-i nuk është në situatë që nuk mund ta kompensojë, andaj propozoj që të jepet në shfrytëzim për periudhën afatshkurtër 15 vjet, por me kompensim.

Dardan Sejdiu tha që asnjë m² të mos i jepet KEDS-it pa kompensim, pra u shpreh i pajtimit me mendimin e zotëri Hamitit, që t'i jepet KEDS-it prona në shfrytëzim për periudhën afatshkurtër - 15 vjet, por me kompensim.

Qëndron Kastrati përkrash formulën, ku i jepet në shfrytëzim vetëm si qiramarrje dhe pronësia mbetet e Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrash Propozimvendimi për dhënien e pronës komunale KEDS-it dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për vazhdimin e afatit shtesë për lirimin e hapësirave nga AKP.

Sami Hamiti u interesua të dijë se kush ka qenë në takim me përfaqësuesit e AKP-së për vazhdimin e afatit shtesë për lirimin e hapësirave nga AKP.

Dardan Sejdiu tha se Bordi i AKP-së ka ardhur këtu te ne, në takim kanë qenë Kryetari dhe Genc Bashota, drejtori i Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Planifikimit Strategjik.

Sami Hamiti tha se AKP-së i ka skaduar afati i kontratës dhe nuk jam për t'i larguar derisa të iniciohet diçka, mos ta vazhdojmë kontratën vetëm deri në prill, por të parashihet mundësia që në momentin kur i fillon procedurat Komuna, dy muaj më herët me i treguar se procedurat kanë filluar dhe brenda afatit dymujor duhet me e liruar, për çdo zhvillim tutje jam për me u larguar, deri në momentin që iniciohen procedurat të mos qiten e me mbetur thatë.

Sugjeroi që dy muaj para skadimit të kontratës të merren vesh palët për lirim apo vazhdim të kontratës. Ajo ka skaduar, tani janë pa kontratë, por meqenëse vazhdohet një pjesë, që 60 ditë më herët Komuna e Prishtinës me një shkresë kërkon lirimin e hapësirës për kohën, dhe nuk ia përcakton.

Qëndron Kastrati u shpreh i pajtimit me mendimin e zotëri Hamitit.

Kryesuesi propozoi që kjo pikë të dërgohet për Kuvend, mirëpo afati shtesë duhet të ndryshohet, të riformulohet.

Dardan Sejdiu u pajtua që të bëhet riformulimi i afatit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për vazhdimin e afatit shtesë për lirim e hapësirave nga AKP dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Të ndryshme

Qëndron Kastrati, lidhur me raportin e auditimit për vitin 2015, tha se jam konsultuar me Kryetarin dhe më ka thënë se nuk është përgatitur, por kur të përgatitet e përcjellim, është çështje e Kuvendit dhe kur të doni mund ta fusni në rend dite.

Kryesuesi tha se afatet ligjore janë të përcaktuara, nuk është çështje e Kuvendit kur mund të futet në rend dite.

Qëndron Kastrati tha se raporti i prokurimit dhe planet e prokurimit, kanë qenë kërkesë e shumë asamblastëve, andaj parashihen për mbledhje të Kuvendit.

Ai po ashtu kërkoi që për mbledhje të Kuvendit të shtohen edhe dy pika të rendit të ditës nga mbledhja e kaluar, çështja e BL-ve dhe e institutit "Atomi".

Kryesuesi theksoi se mundemi t'i fusim si pika shtesë për Kuvend, mirëpo duhet të konsultohemi me Kryetarin.

Dardan Sejdiu tha se GP-të në takimin para mbledhjes së Kuvendit, mund të dakordohen për rrugën përpara.

Sami Hamiti propozoi që të dërgohen në Ministri këto tri pikat për planet rregulluese. Nëse Ministria thotë se ato janë të ligjshme, atëherë ato do të trajtohen në Kuvend dhe i votojmë. Sipas ligjit të ri këto plane rregulluese nuk janë në fuqi, nuk ekzistojnë, ekzistojnë shkresa të ndryshme.

Dardan Sejdiu propozoi që këto tri pika të dalin si propozime në Kuvend, për t'i futur si pika të rendit të ditës çështjen e BL-ve, të institutit "Atomi" dhe të propozimit për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.

Sami Hamiti propozoi të futen këto pika, sepse kanë kaluar në Komitet, jemi pajtuar, vetëm mbetet të konsultoheni me Kryetarin.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

Procesmbajtës:
Zijadin Gashi dhe
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.

